VENDIM
Nr. 594, datë 7.9.2022

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "ELEMENT IT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 39, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), për zbatimin e projektit "Element IT", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT,
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "ELEMENT IT"
24.8.2022

Ky Memorandum Mirëkuptimi **("Memorandumi")** lidhet ndërmjet:

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ***(Albanian-American Development Foundation),*** një organizatë jofitimprurëse e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të *Delaware*-it, me seli në 780 Third Ave, kati 46, New York, NY 10017, SHBA, që vepron me anë të degës së saj në Shqipëri, të regjistruar me vendimin nr. 359, datë 18.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me zyrë të regjistruar në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", ndërtesa 42, hyrja 7, apartamenti 60, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli, drejtorë ekzekutivë të përbashkët (në vijim referuar si **"AADF"),**

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar në këtë Memorandum nga Znj. Bora Muzhaqi, në cilësinë e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nënshkrues i autorizuar (në vijim referuar si **"Këshilli i Ministrave"),**

individualisht referuar në këtë Memorandum si "Pala", dhe bashkërisht si "Palët", MEQENËSE:

A. Përgjatë dy dekadave të fundit, qeveritë dhe mësuesit në mbarë botën kanë njohur premisat e jashtëzakonshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK);

B. Bordi i drejtorive të AADF-së ka miratuar projektin "Element IT", për përfshirjen e lëndës TIK në planin mësimor të shkollave fillore publike, për klasat I, II dhe III **("Projekti");**

C. Me anë të këtij Projekti, AADF-ja synon fillimisht të testojë dhe më pas të zgjerojë përfshirjen e lëndës TIK në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

D. Palët ndajnë të njëjtin këndvështrim për rëndësinë e rritjes së cilësisë së edukimit në teknologji që në arsimin fillor;

E. Këshilli i Ministrave dhe AADF-ja dëshirojnë të bashkëpunojnë për realizimin e Projektit, sipas kompetencave dhe fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh angazhimet e deritanishme, Palët lidhin këtë Memorandum për të zyrtarizuar marrëdhënien e tyre bashkëpunuese, sipas kushteve të mëposhtme:

1. QËLLIMI

1.1 Ky Memorandum ka si synim konfirmimin e angazhimit të përbashkët dhe ndërtimin e një marrëdhënie bashkërenduese dhe bashkëpunuese mes Palëve për përfshirjen e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në planin mësimor të arsimit bazë në Shqipëri, nga klasa e parë deri në klasën e tretë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë dokument.

1.2 Palët bien dakord të kontribuojnë dhe angazhohen për përmbushjen e qëllimit të këtij Memorandumi, sipas kompetencave dhe fushave përkatëse të përgjegjësisë.

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT

2.1 Projekti është hartuar dhe miratuar nga AADF-ja për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zbatohet në bashkëpunim mes palëve. Ai synon zbatimin e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në shkollat e arsimit bazë, në përputhje me planin mësimor të arsimit bazë në Shqipëri, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit që parashikon përfshirjen e lëndës së TIK-ut në lëndët me zgjedhje të klasave I–III.

2.2 Projekti do të zbatohet në këto faza:

2.2.1 Viti I – Zbatimi i kurrikulës TIK në klasat e para, në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit të pajisura me laborator të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të quajtur Laborator Smart (në vijim **"Laborator Smart");**

2.2.2 Viti II – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës TIK në klasat e para, në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik të vendit të pajisura me Laborator Smart. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kurrikulës së TIK-ut në klasat e dyta, në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit;

2.2.3 Viti III – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës së TIK-ut në klasat e dyta, në të gjitha shkollat e arsimit bazë, publike, të pajisura me Laborator Smart. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kurrikulës së TIK në klasat e treta në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit;

2.2.4 Viti IV – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës së TIK-ut në klasat e treta, në të gjitha shkollat e arsimit bazë, publike, të vendit të pajisura me Laborator Smart;

2.2.5 Viti V – Vlerësimi i zbatimit dhe i ndikimit të Projektit.

2.3 Objektivat e përgjithshëm të Projektit janë:

2.3.1 Përfshirja e kurrikulës TIK në planin mësimor për klasat I, II dhe III, dhe shtrirja e zbatimit të saj në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

2.3.2 Ofrimi i një platforme plotësuese *online* për të mbështetur mësimdhënien dhe të mësuarit e kodimit dhe të të menduarit kompjuterik në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

2.3.3 Trajnimi i mësuesve për zhvillimin e lëndës së re TIK.

3. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

3.1 Angazhimet e përbashkëta të Palëve përfshijnë, por nuk kufizohen, në sa më poshtë:

2.1.1 Palët do të angazhohen për zbatimin e fazës së parë (viti I) të Projektit në 100 shkollat e arsimit bazë publik të përzgjedhura për vitin shkollor 2022–2023, duke zgjeruar zbatimin e tij në të gjitha shkollat e arsimit bazë në Shqipëri përgjatë vitit të dytë deri në vitin e katërt të Projektit, sipas fazave të tij të parashikuara në nenin 2 të Memorandumit;

2.1.2 Palët do të kontribuojnë dhe ofrojnë njohuritë *(know-how),* ekspertizën dhe pronësinë intelektuale për realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi;

2.1.3 Palët do të informojnë dhe konsultohen me njëri-tjetrin, në mënyrë të rregullt, për çështjet me interes të përbashkët;

2.1.4 Secila Palë do të caktojë nga një pikë kontakti për çdo çështje që lidhet me zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij Memorandumi;

3.2 Për qëllim të këtij Memorandumi, AADF-ja do të:

3.2.1 Financojë dhe administrojë fondet e veta, për:

3.2.1.1 Identifikimin dhe kontraktimin e ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas procedurave të veta, për hartimin e kurrikulës TIK për klasat I, II dhe III të shkollave të arsimit bazë publik;

3.2.1.2 Ofrimin e trajnimit të mësuesve të lëndës TIK, të përfshirë në Projekt, sipas fazave të zbatimit të tij, pa përfshirë kostot e transportit apo të akomodimit të mësuesve pjesëmarrës në trajnim;

3.2.1.3 Blerjen e 1,600 pajisjeve kompjuterike, sipas procedurave të veta, për 100 laboratorët Smart, që do të ndërtohen nga qeveria shqiptare në 100 shkollat e përzgjedhura për fazën e parë të Projektit;

3.2.1.4 Vënien në dispozicion dhe përdorimin e platformës për mësimin e kodimit në klasat I, II dhe III për 4 vitet e para të Projektit, sipas planit të dakordësuar të shtrirjes së tij në shkollat e arsimit bazë;

3.2.2 Mbikëqyrë zbatimin e Projektit dhe do të vlerësojë ndikimin e tij pas 4 viteve të para të implementimit të Projektit.

3.3 Për qëllim të këtij Memorandumi, Këshilli i Ministrave do të:

3.3.1 ngrejë një grup ndërinstitucional pune me përbërje nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF), Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për koordinimin e institucioneve shtetërore dhe bashkërendimin e punëve për realizimin e të këtij Memorandumi, ku AADF-ja do të ftohet në çdo rast të marrë pjesë nëpërmjet përfaqësuesve të saj.

3.3.2 identifikojë dhe dakordësojë me AADF-në 100 shkollat e arsimit bazë publik ku do zbatohet Projekti për vitin e parë dhe të realizojë, me fondet e buxhetit të shtetit, ngritjen e 100 laboratorëve Smart, nga një laborator në secilën shkollë të rënë dakord, duke i pajisur ato me mjetet e nevojshme, përfshirë rrjetin kompjuterik, elektrik, ekran interaktiv, mikrokompjutera të programueshëm, bazuar në standardet teknike të përgatitura nga AKSHI, përpara fillimit të vitit shkollor 2022–2023;

3.3.3 ngrejë, me fondet e veta, laboratorët SMART në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik ku do të shtrihet zbatimi i kurrikulës TIK dhe t'i pajisë ato me mjetet e nevojshme, përfshirë rrjetin kompjuterik, elektrik, pajisje kompjuterike, ekran interaktiv, mikrokompjutera të programueshëm, bazuar në standardet teknike të përgatitura nga AKSHI, për shtrirjen e zbatimit të Projektit në të gjitha shkollat fillore të vendit në vitin II të Projektit e në vijim;

3.3.4 ofrojë mbështetjen institucionale të nevojshme dhe të bashkëpunojë gjatë gjithë fazave të hartimit të kurrikulës TIK nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, ndër të tjera, duke vënë në dispozicion dokumentacionin dhe të dhënat e disponueshme që mund të nevojiten gjatë këtij procesi, si dhe do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe miratojë aktet e nevojshme për miratimin dhe përfshirjen e kësaj kurrikule në shkollat e arsimit bazë publik;

3.3.5 identifikojë, në bashkëpunim me AADF-në, listën e mësuesve të lëndës në klasat ku do të zbatohet kurrikula TIK, të cilët do të trajnohen për zhvillimin e lëndës TIK dhe të sigurojë angazhimin e tyre për t'u trajnuar sipas fazave të zbatimit të Projektit;

3.3.6 ofrojë mbështetje logjistike për realizimin e trajnimit të mësuesve, që do të përfshihen në Projekt me fonde të AADF-së, duke përfshirë vënien në dispozicion pa kundërshpërblim të ambienteve të përshtatshme për realizimin e trajnimeve;

3.3.7 bashkëpunojë me AADF-në për të rishikuar të gjithë kurrikulën TIK në të gjitha klasat e sistemit parauniversitar për të siguruar koherencën ndër klasa, si dhe përditësimin e saj;

3.3.8 sigurojë nënshkrimin përmes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të marrëveshjes përkatëse të licencës për përdorimin e platformës për mësimin e kodimit, që do të financohet nga AADF-ja;

3.3.9 mbulojë me fondet e veta, të gjitha kostot e zbatueshme për përdorimin e platformës për mësimin e kodimit pas vitit të katërt të Projektit e në vijim dhe të vlerësojë mundësinë e përdorimit të një platforme për mësimin e kurrikulës TIK edhe për klasat IV–XII;

3.3.10 të caktojë institucionin qendror përgjegjës për marrjen në dorëzim të pajisjeve kompjuterike që do të blihen nga AADF-ja, të sigurojë shpërndarjen e këtyre pajisjeve në shkollat e përzgjedhura dhe të pajisura me laborator Smart dhe të marrë të gjitha masat e arsyeshme për ruajtjen e këtyre pajisjeve, si dhe për t'i zëvendësuar ato në rast humbjeje ose dëmtimi, për të garantuar zbatimin efikas të Projektit, përgjatë kohëzgjatjes së tij.

4. PRONËSIA INTELEKTUALE

4.1 Palët bien dakord dhe pranojnë se çdo produkt apo krijimtari që rezulton nga veprimtaria e AADF-së, në lidhje me këtë Projekt, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhura me të, janë pronë e vetme e AADF-së. AADF-ja i jep të drejtën joekskluzive dhe pa kundërshpërblim Këshillit të Ministrave, për të përdorur kurrikulën TIK të hartuar nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, gjatë kohëzgjatjes së këtij memorandumi, për qëllim të zbatimit të Projektit.

4.2 Pa paragjykuar sa më sipër, palët bien dakord dhe pranojnë se AADF-ja nuk mban përgjegjësi për origjinalitetin dhe/ose cilësinë e kurrikulës TIK, që do të hartohet nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, por kjo e fundit angazhohet të sigurojë nga ekspertët, deklaratë mbi origjinalitetin dhe/ose cilësinë e kurrikulës TIK të hartuar.

4.3 Këshilli i Ministrave deklaron dhe garanton se nuk do të cenojë apo shkelë të drejtat e pronësisë intelektuale të AADF-së dhe palëve të treta të kontraktuara nga AADF-ja, për qëllim të zbatimit të këtij Projekti, dhe angazhohet të njoftojë AADF-në menjëherë, në rast se vihet në dijeni të ndonjë shkeljeje. Përveç autorizimit me shkrim nga AADF-ja, Këshilli i Ministrave nuk do të përdorë ose kopjojë materiale apo informacione në pronësi të AADF-së, përfshirë materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit, sekrete tregtare, logo, marka tregtare, emra *domain*, *software*, llogari në medie sociale apo çdo pronë tjetër intelektuale të kësaj të fundit. Ky detyrim i Këshillit të Ministrave do të mbetet në fuqi pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së këtij Memorandumi.

5. DEKLARIMET PUBLIKE

5.1 Për qëllim të këtij Memorandumi, **"Deklaratë publike"** do të thotë çdo shpërndarje informacioni te publiku, në lidhje me Projektin, nëpërmjet komunikatave për shtyp, çdo prodhim audiovizual dhe të shkruar në formën e intervistave, dokumentarëve, emisioneve, deklaratave ose daljeve publike, përfaqësuesve, personave të autorizuar ose punonjësve të saj, në medie, rrjete sociale dhe çdo formë tjetër komunikimi publik.

5.2 Secila Palë do të njohë dhe përmendë në çdo deklaratë publike kontributin e Palës tjetër në lidhje me zbatimin e Projektit. Palët do të informojnë dhe konsultohen paraprakisht me njëra-tjetrën për çdo Deklarata Publike, në lidhje me Projektin. Këshilli i Ministrave mund të lëshojë komunikata shtypi, kryejë Deklarata Publike ose komunikojë me medien, në lidhje me Projektin, pas miratimit paraprak të AADF-së. AADF-ja nuk do të vonojë ose refuzojë në mënyrë të paarsyeshme dhënien e miratimit, sipas këtij neni për informimin e publikut nga Këshilli i Ministrave në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore.

5.3 Palët do të njohin dhe përmendin në gjuhë të përshtatshme në të gjitha Deklaratat Publike, burimin e fondeve të përdorura për Projektin nëpërmjet kontributit të AADF-së, si fonde të Qeverisë Amerikane, të cilat kanë për qëllim të jenë dhurim i popullit amerikan për qytetarët shqiptarë, për të ndërtuar dhe përforcuar më tej miqësinë që ekziston ndërmjet dy vendeve. Kjo gjuhë do të përshihet në të gjithë informacionin që ndahet me publikun, duke përfshirë por pa u kufizuar në të gjitha deklaratat, në lidhje me Projektin ose aktivitete të tjera, broshura, faqe interneti, publikime ose informacion të ngjashëm që ofrohet ose shpërndahet nga/ose nëpërmjet secilës Palë.

5.4 Palët do të bashkëpunojnë në zhvillimin e materialeve promovuese, në lidhje me Projektin. Logot e AADF-së dhe të Këshillit të Ministrave do të jenë të dukshme dhe do të vendosen në mënyrë të qartë gjatë aktiviteteve të Projektit dhe fushatave publike, në çdo material promovues,

banera, postera, komunikata për shtyp, fletushka dhe çdo lloj tjetër materiali publicitar, deklaratë publike apo publikime që do të bëhen në bazë të këtij Projekti. Logoja e AADF-së do të jetë në përmasa dhe dominim ekuivalent me logot e tjera, të tilla si Këshilli i Ministrave apo institucione të tjera shtetërore.

6. KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

6.1 Secila nga Palët e këtij Memorandumi merr përsipër të mos bëjë të ditur, përhapë ose komunikojë informacione në lidhje me veprimtarinë e Palës tjetër, kushtet dhe ekzistencën e këtij Memorandumi, që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku **("Informacioni Konfidencial").** Gjithashtu, secila Palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime të tjera përveç qëllimit të këtij Memorandumi.

6.2 Palët angazhohen të ruajnë të dhënat sensitive, personale dhe privatësinë e informacionit që mund të vihen në dijeni gjatë bashkëpunimit dhe zbatimit të këtij Memorandumi dhe t'i trajtojnë këto të dhëna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.3 Ky detyrim i ndërsjellë i Palëve për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale do të mbetet në fuqi pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së këtij Memorandumi.

7. KOMUNIKIMI DHE KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të këtij Memorandumi. Si rregull, komunikimi kryhet në formë shkresore, por edhe në formatin e komunikimit elektronik.

8. DEKLARIMET E GARANCISË

Në këtë datë, Palët deklarojnë dhe garantojnë sa më poshtë:

8.1 Ato kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të lidhur këtë Memorandum;

8.2 Ato kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e lidhjes së këtij Memorandumi dhe për përmbushjen e angazhimeve të tyre sipas këtij Memorandumi.

9. PRONËSIA E INVESTIMIT TË AADF-së

9.1 Para fillimit të vitit shkollor 2022–2023, AADF-ja do t'i dorëzojë Këshillit të Ministrave pajisjet kompjuterike dhe Këshilli i Ministrave, nëpërmjet institucioneve të saj përkatëse, do t'i shpërndajë ato në shkollat e përzgjedhura me laborator TIK.

9.2 Të gjitha pajisjet kompjuterike të investuar nga AADF-ja, sipas këtij Memorandumi, do t'i dhurohen institucionit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe do të kalojnë në pronësi të këtij institucioni me pranimin e dhurimit dhe marrjen e tyre në dorëzim.

10. KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA

10.1 Ky Memorandum hyn në fuqi në datën kur AADF-ja merr njoftim me shkrim nga Këshilli i Ministrave për përfundimin e procedurave të brendshme të miratimit nga ky i fundit dhe është i vlefshëm deri në datën zyrtare të përfundimit të Projektit, përveçse kur zgjidhet paraprakisht nga njëra prej Palëve, sipas parashikimeve të mëposhtme të këtij neni.

10.2 Ky Memorandum mund të zgjidhet para përfundimit të afatit të mësipërm nga secila Palë nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim drejtuar Palëve të tjera të paktën 1 (një) muaj, afat ky me kalimin e të cilit Memorandumi quhet i zgjidhur për atë Palë. Palët e tjera mund të vendosin të vijojnë bashkëpunimin e tyre për zbatimin e Projektit, nëse diçka e tillë është e mundur.

10.3 Secilës Palë i lind e drejta që në çdo kohë ta zgjidhë këtë Memorandum me efekt të menjëhershëm, me një njoftim me shkrim drejtuar Palës tjetër, nëse kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e caktuara në këtë Memorandum, edhe nëse kjo nuk është e mundur, të provohet me prova shkresore.

11. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

11.1 Ky Memorandum do të rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

11.2 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përmbushjen e kushteve dhe të afateve të këtij Memorandumi. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet

që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim, nëpërmjet bisedave dhe negociatave midis Palëve.

11.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi, vlefshmëria, zbatimi, zgjidhja ose në lidhje me shkeljen e ndonjë kushti të këtij Memorandumi, të cilat nuk janë mundur të zgjidhen miqësisht, do t'i referohen Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar (MEDART), Tiranë, Shqipëri. Mosmarrëveshja do të gjykohet nga një gjykatës i vetëm, i cili do të emërohet nga drejtori i përgjithshëm i MEDART-it, brenda 7 ditëve nga data kur MEDART-i është njoftuar për kërkesën e arbitrazhit.

11.4 Rregullat procedurale që duhet të zbatohen janë ato të përcaktuara nga MEDART-i dhe gjuha e arbitrazhit është gjuha shqipe. Vendimi i gjykatësit do të jetë përfundimtar dhe ligjërisht i detyrueshëm dhe i zbatueshëm për Palët.

12. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

AADF-ja gëzon imunitetin dhe të drejtat e siguruara nga Marrëveshja Bilaterale Ekonomike e nënshkruar midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) datë 10 qershor 1992, ratifikuar me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 224 datë 11.6.1992.

13. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

13.1 Ky Memorandum përbën mirëkuptimin në tërësi të Palëve dhe asnjë kusht, afat, mirëkuptim ose marrëveshje, që synon të ndryshojë kushtet e këtij Memorandumi nuk do të jetë detyrues, përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjitha Palët.

13.2 Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mund të rregullohet me marrëveshje ose kontrata të veçanta, duke bërë përpjekjet më të mira për përmbushjen nga të gjitha Palët. Palët mund të bien dakord për këto marrëveshje shtesë, në rast se mund ta gjykojnë të përshtatshme nga pikëpamja e eksperiencës, për të përmirësuar ose zhvilluar një aspekt të caktuar të bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi.

13.3 Gjuha e këtij Memorandumi dhe gjuha për komunikimet, sipas këtij Memorandumi do të jetë gjuha shqipe.

13.4 Ky Memorandum është detyrues për Palët, pasardhësit e tyre dhe përfituesit e të drejtave të tyre përkatëse.

13.5 Ky Memorandum është nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

FONDACIONI SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM

FONDACIONI SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM

_____

Z. Martin Mata
Drejtor ekzekutiv

Datë 24.8.2022

_____

Z. Aleksandër Sarapuli
Drejtor ekzekutiv

KËSHILLI I MINISTRAVE

_____

Znj. Bora Muzhaqi
Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
Datë 24.8.2022